

LEJA E PAGUAR E MINNESOTA

Në fuqi nga data 1 janar 2026

Leja e paguar e Minnesota ofron pagesa dhe mbrojtje në punë kur juve ju nevojitet kohë larg punës për t'u kujdesur për veten ose familjen tuaj.

Për çfarë mund ta përdor lejen e paguar?

Leja mjekësore:

- Për t'u kujdesur për gjendjet tuaja serioze shëndetësore, duke përfshirë kujdesin e lidhur me shtatzëninë, lindjen dhe rikuperimin

Leja familjare:

- **Leja për të krijuar lidhje** – për t'u kujdesur dhe për të krijuar lidhje me një fëmijë të ri të marrë përmes lindjes, adoptimit ose kujdestarisë familjare
- **Leja e kujdesit** – për t'u kujdesur për një anëtar të familjes me një gjendje të rëndë shëndetësore
- **Leja familjare ushtarake** – për të mbështetur një anëtar të familjes që është thirrur për shërbim ushtarak
- **Leja për arsye sigurie** – për t'iu përgjigjur problemeve të lidhura me dhunën shtëpiak, dhunën seksuale ose përndjekjen tuaj ose të një anëtari të familjes

Në përgjithësi, gjendjet duhet të zgjasin më shumë se shtatë ditë dhe të vërtetohen nga një ofrues i kujdesit shëndetësor ose profesionist tjetër.

A jam i/e mbuluar nga leja e paguar?

Shumica e punonjësve në Minnesota janë të mbuluar nga leja e paguar. Ju jeni i/e mbuluar pavarësisht madhësisë së punëdhënësit tuaj apo orëve ose ditëve që punoni. Kontraktorët e pavarur dhe individët e vetëpunësuar nuk mbulohen automatikisht, por mund të zgjedhin të përfshihen. Ju mund të kualifikoheni për pagesa nëse jeni paguar një shumë minimale për punën në Minnesota gjatë vitit të shkuar (\$3,900 për nisjen e lejes së paguar në vitin 2026).

Për sa kohë mund të marr leje?

Ju mund të kualifikoheni të merrni deri në 12 javë leje familjare ose mjekësore për çdo vit përfitimi. Nëse ju nevojitet edhe leje familjare, edhe mjekësore gjatë të njëjtit vit përfitimi, mund të kualifikoheni për deri në 20 javë në total.

Sa do të paguhem?

Kur përdorni lejen e paguar, shteti ju jep pagesa. Leja e paguar do të paguhet deri në 90% të pagave tuaja, bazuar në nivelin e të ardhurave tuaja, me një shumë maksimale javore të përcaktuar në pagën mesatare javore të shtetit. Kjo shumë ndryshon çdo vit, dhe për nisjen e lejes së paguar në vitin 2026 është \$1,423.

Kush paguan për lejen e paguar?

Leja me të drejtë page financohet nga primet e paguara nga punonjësit dhe punëdhënësit. Norma fillestare e primit është 0,88% e pagave të mbuluara. Punëdhënësi juaj mund të zbresë deri në 0,44% të pagës suaj për të financuar pjesën tuaj të primit.

Cilat janë mbrojtjet e punësimit tim?

- **Mbrojtjet në punë:** Në përgjithësi, ju duhet të riktheheni në punë ose në një pozicion ekuivalent kur të ktheheni nga leja. Mbrojtjet në punë hyjnë në fuqi 90 ditë pas datës së marrjes suaj në punë.
- **Vazhdimi i sigurimit shëndetësor:** Në përgjithësi, punëdhënësit duhet të vazhdojnë të financojnë pjesën e tyre të primeve të sigurimit shëndetësor ndërkohë që ju jeni me leje.
- **Mos-shpagimi dhe mos-ndërhyrja:** Punëdhënësit nuk duhet të ndërhyjnë apo të shpagojnë kundër jush nëse ju aplikoni ose përdorni leje të paguar. Punëdhënësit nuk mund t'ju marrin pagesat tuaja të lejes së paguar.

Për pyetjet në lidhje me lej e paguar, ju lutemi kontaktoni me Lejen e Paguar të Minnesota në 651-556-7777 ose vizitoni faqen tonë të internetit.

Nëse mendoni se punëdhënësi juaj po shkel mbrojtjet e punësimit, kontaktoni me Labor Standards Division (Divizionin e Standardeve në Punë) pranë Minnesota Department of Labor and Industry (Departamentit të Punës dhe Industrisë të Minnesota).



MËSONI MË SHUMË: paidleave.mn.gov

Ky informacion mund të ofrohet në formate alternative për personat me aftësi të kufizuara ose ata që kanë nevojë për asistencë gjuhësore, duke telefonuar qendrën e kontaktit të Lejes së Paguar në numrin 651-556-7777 ose 844-556-0444 (pa pagesë).

m MINNESOTA
PAID LEAVE